



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:148523

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05799571

C.nr.654/21

GJYKATA THEMELORE NË PRZIREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve SH.B, SH.L, S.L, U.K, V.K, V.H dhe S.L, që të gjithë të punësuar në SH.F.M.U “Ramë Bllaca”, në fshatin B, K e S, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit B. K, avokat nga S, kundër të paditurës K e S – D e A, të cilën e përfaqëson sipas akt emërimit përfaqësuesi ligjor A. B nga S, për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit/licencimit, me datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Pa Shqyrtim Kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve SH.B, SH.L, S.L, U.K, V.K, V.H dhe S.L, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A, në S, që paditësve në emër të kompensimit të diferencës se pagesës për kualifikim – licencim, t’ia paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses Sh. B, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 08.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (55 muaj), shumën prej 2,841.30 euro;
- Paditëses Sh. L, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 08.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (55 muaj), shumën prej 3,044.25 euro;
- Paditësit S. L, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 08.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (55 muaj), shumën prej 3,044.25 euro;
- Paditësit U. K, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 08.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (55 muaj), shumën prej 3,044.25 euro;

- Padi tëses V. K, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 01.09.2020 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (29 muaj e 6 ditë), shumën prej 1,616.22 euro;
- Padi tëses V. H, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 01.09.2020 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (29 muaj e 6 ditë), shumën prej 1,616.22 euro;
- Padi tëses S. L, kompensimin e diferencës së pa paguar në pagë, për shkak të kualifikimit dhe atë për periudhën 08.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, gjegjësisht për (55 muaj), shumën prej 3,044.25 euro.

Që të gjitha këto në shuma si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (08.07.2021) e deri ne pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përbarimit të detyrueshëm.

- II.** REFUZOHET kërkesëpadia për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 07.07.2018, për shkak të parashkrimit të kërkesave, ndërsa pjesa tjetër përtej shumës së aprovuar si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, REFUZOHET si e pabazë.
- III.** DETYROHET e paditura K e S, t'ia kompenson paditësve shpenzimet e procedurës në vlerë prej 645.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Padi tësit përmes të autorizuarit të tyre Av. B. K, kanë parashtruar padi më 08.07.2021, pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K e S – D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shtesave në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit për shkak se e paditura K e S nuk ka vepruar konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, respektivisht nenin 7 paragrafi 1 të saj. Po ashtu ka shtuar se bazuar në dispozitat ligjore, konkretisht parag. 1.3 të nenit 7 të KKAK-së, padi tësve iu takon rritja e pagës mbi bazën e kualifikimit – gradimit në vlerë prej 27% të pagës bazë dhe atë prej datës 18.04.2017 e deri me datë 22.07.2021. Po ashtu ka shtuar se sipas dispozitave të LMD-së, gjegjësisht nenit 245 par.1, parashihet se *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë më ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

I autorizuari i padi tësve me datë me parashtrësën e datës 13.11.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv me të cilën ka kërkuar që padi tësve

t'iu njihen diferencat e papaguara, duke marrë për bazë mendimin juridik Nr. 214/2023 të Gjykatës Supreme, Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017, përkatësisht nenin 7 të kësaj kontrate.

Me parashtresën e datës 22.05.2024, e autorizuara e paditësve ka bere precizimin e padisë në aspektin subjektiv, ku ka shtuar si paditëse në këtë çështje, paditësen B. K.

E paditura K e S – DKA, përmes të autorizuarit të saj theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësi ka nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit, përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 ndërlidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, i aprovoi kërkesëpaditë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kontratave të punës për mësimdhënësit të cilët janë paditës në këtë çështje.

Kontestues ishte fakti nëse paditësit janë të pajisur me licencë karriere dhe nëse të njëjtit janë paguar lidhur me diferencat e kualifikimit – licencimit.

Faktin se paditësit janë të pajisur me licenca karriere, gjykata e vërtetoi nga Licenca me nr.100012255, për paditësen Sh. B, Licenca me nr.100012575, për paditësen Sh. L, Licenca me nr.100007857, për paditësin S. L, Licenca me nr.100012250, për paditësin U. K, Licenca me nr.1026180, për paditësen V. K, Licenca me nr.100012256, për paditësen S. L.

Ndërsa faktin se paditësit nëse janë paguar në emër të kualifikimit, gjykata e vërtetoi nga lista e pagave, ku është vërtetuar se të njëjtit janë kompensuar në emër të kualifikimit, por jo në shumat që ju takon, për çka gjykata vendosi që të ju njeh diferencat e papaguara në emër të kualifikimit – licencimit, për muajt për të cilët nuk janë kompensuar.

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*
- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të Mendimit Juridik me numër të protokollit 214/2013 të dt.09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Suharekës.

Gjykata deri te shumat e aprovuara ka ardhur duke ia llogaritur secilit paditës pagën bazë herë përqindjen në bazë të kualifikimit – licencimit, shuma e arritur nga kjo iu është minusuar me të ardhurat që i kanë siguruar paditësit gjatë marrëdhënies së punës, ku shuma e mbetur iu është shumëzuar me muajt të cilët përfshin të drejtën për të siguruar diferencën e papaguar, duke arritur kështu në shumën përfundimtarë aprovuese për secilin paditës veç e veç.

Në lidhje me vendosje si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar pretendimet e palës së paditur në përgjigje në padi, ku ka deklaruar se konform nenit 87 të Ligjit të Punës, kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave. Gjykata konstaton se padia është paraqitur me datë 07.07.2021, e që i bie se nëse kthehemi tre vite mbrapa atëherë kërkesëpaditë për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 07.07.2018, kanë arritur afatin e parashkrimit. Ndërsa gjykata pjesën tjetër përtej shumës së aprovuar si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi e refuzoi si ta pabazë për faktin se, ashtu siç theksuar edhe më lartë nga llogaritja e diferencës së papaguar gjykata vlerëson se paditësve duhet t’u kompensohet diferenca e aprovuar si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

ndërsa pjesa tjetër e kërkuar nga ana e paditësve përtej shumes së aprovuar është e pabazuar në ligj dhe prova.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, shumë prej 624.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumë prej 21.00 euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve) në shumë të përgjithshme prej 645.00 euro.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:148523, 10.06.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.